

PELLAZGËT GJITHNJË E MË AFËR

Qyshkur u hodhën tezat e para nga dijetarë të ndryshëm lidhur me prejardhjen pellazgjike të shqiptarëve, rruga për te pellazgët u duk e vështirë. Dhe jo e lehtë mbetet dhe sot e kësaj dite, por jo e pamundur për të ecur në të.

Arritjet e historiografisë, të gjuhësisë dhe, në veçanti të arkeologjisë në çështjen e rëndësishme të autoktonisë dhe të kulturës së popullit shqiptar, të lashtësisë dhe të sferës botëkuptimore në marrëdhënie me lashtësinë e popujve të tjerë fqinjë dhe më gjerë, kanë çarë tanimë rrugën për të bërë kërkime dhe hulumtime të mëtejshme në këtë fushë.

Rreth pellazgëve ka një literaturë të tërë, që nga Homeri e deri te autorët e sotëm. Nuk janë të pakta edhe njoftimet, tezat dhe hamëndjet e studiuesve të kohëve të reja rreth prejardhjes pellazgjike të shqiptarëve të sotëm.

J. G. Hani (Hahn) që më 1854 hodhi tezën se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve, dhe këta të fundit janë pasardhës të pellazgëve. Sipas Hanit, ilirishtja është një gjuhë pellazgjike, në një kuptim të gjerë. Rreth këtij raporti gjuhësor këtë mendim kanë shumë studiues të huaj të ditëve tona.

Që shqiptarët janë pasardhës të ilirëve, kjo tanimë është provuar katërcipërisht nga shkenca e arkeologjisë, e gjuhësisë dhe nga shkenca të tjera.

Ndërkohë, mbetet i hapur problemi se a janë pellazgët një hallkë në zinxhirin e vijimësisë ilire-shqiptare. Për këtë, janë shfaqur mendime që së lashti nga autorë grekë e romakë, siç u tha më sipër, për të vazhduar në rrymën e shekujve dhe për të ardhur te studiues të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj të ditëve tona.

Në shkrimet për pellazgët si pararendës të ilirëve dhe shqiptarëve autori është përpjekur të qëmtojë ku ka mundur, të dhëna të grimcuara që priren të hedhin sado pak dritë mbi atë zbrazëtirë të mjegullt të botës mendore dhe shpirtërore të epokës ilire, për të arritur në kohët e mëvonshme, ku, fatmirësisht, shumëçka nga parailirët (t'i quajmë këta pellazgë) na është bërë

e njohur nga autorët antikë dhe të kohëve të mëvona, nga gjetjet arkeologjike, nga ritet, kultet, etj., të ruajtura në legjenda, në këngët epike, në simbolikë, ornamentikë e madje, edhe pse e fundit, jo më pak e rëndësishme, në gjuhë.

Hapësira gjeografike e pellazgëve

Autorët grekë dhe romakë i shtrijnë pellazgët që nga bregdeti i Azisë së Vogël, në pellgun e Egjeut, në Kretë, në Thesali, Epir, Peloponez deri në gadishullin Italik.

Nga kanë ardhur pellazgët? Ka studiues që thonë se duhet të kenë ardhur nga Azia Qendrore dhe janë dukur në viset që u përmendën më sipër, aty nga mesi i neolitit, rreth 3500 vite para erës së re. Shkenca jonë arkeologjike shënon se nga mesi i mijëvjeçarit IV deri rreth viteve 2600 ka ekzistuar një qytetërim neolitik i një popullsie që grekët e quajtën me emrin “Pellazg”, që duket se kishin diçka të veçantë në pamjen fizike, në mënyrën e të folurit në “s” të zgjatur (Lissos, Issa, Larissa etj.)¹

Historiani francez Fystel de Kulanzh, në veprën e tij “Qyteti-shtet antik” (1864), duke folur për grekët, romakët, hinduset e të tjerë, shënon se të gjithë këta “i përkisnin të njëjtës racë; të parët e tyre në një epokë shumë të largët kanë pasë jetuar në Azinë Qendrore. Pikërisht aty zunë fill besimet dhe ritet në këta popuj”.

Edhe dijetari ynë i shquar Sami Frashëri, duke folur për pellazgët, thotë: “Duket se këta erdhën më parë se të gjithë prej mesit të Azisë në Europë”.

“Niebuhr i bënte pellazgët popullin më të përhapur në Europë, përpara se të fillonte historia e Greqisë”.²

Mjaft studiues janë të mendimit se pellazgët kanë qenë një popullsi e madhe, që kanë mbuluar Azinë e Vogël, Greqinë, Ballkanin deri në pellgun danubian, një pjesë të gadishullit italik etj., ku lanë gjuhën e tyre dhe hyjnitë, që helenët dhe italikët i përvetësuan.

Babai i historisë së Greqisë, Herodoti, i quan pellazgët popullsi autoktone që ka banuar në Greqi, përpara ardhjes aty të helenëve. Fisi helen, sipas Herodotit, përfaqëson valën e emigrantëve. Po të kemi parasysh përhapjen e pellazgëve në

brigjet e Mesdheut, në Ballkan, në Azi të Vogël, në gadishullin italik e gjetkë, nga mijëvjeçari IV deri në mijëvjeçarin II, koha kur fiset helene erdhën dhe u vendosën në jug të Ballkanit, territori i Helladës ka qenë mjaft i rrudhur, në krahasim me hapësirën që zinin fiset pellazge. Sipas Skyllaksit, Hellada fillonte nga gjiri i Ambrakisë e poshtë. Edhe Straboni shënon se ajo nga ana perëndimore dhe veriore kufizohet me fiset epirote dhe ilire, ndërsa nga lindja me fiset maqedone deri në Bizant.

Historiani i lashtë grek Tuqididi, duke folur për Helladën, thotë se ajo nuk ekzistonte më parë dhe se “emrin asaj ia dhanë, sipas emrave të tyre, fiset e ndryshme, më tepër pellazgët”.

Shkëndijime pellazge ka edhe në Kaukaz. Duket, të ardhur nga Azia Qendrore, kanë bërë ndalesa të ndryshme, duke lënë kudo gjurmë të tyre. Studiuesi grek M.B.Saqellariu në veprën “Popuj helenë me origjinë indoevropiane” shënon se pellazgët kanë hyrë në Maqedoni nga veriu. Një traditë e lashtë ruan kujtesën se në Maqedoni kanë banuar edhe frigjët, fis pellazg në Azinë e Vogël, ku kishte edhe fise të tjera pellazge, si: lidianet, karianët, likianët, trojanët. Shumë hyjni të panteonit mitologjik, që grekët i morën nga pellazgët (Herodoti), i gjejmë edhe në popujt e Azisë së Vogël, shumë më parë kolonizimit të tyre nga grekët.

Ka studiues që i ngacmon disi termi **pellazg**. Bukur! Le t'i quajmë pellazgët protoilirë, preilirë, s'ka rëndësi. Puna është të ecim në një rrugë që na lejon të shtyhem sa më thellë në kërkim të lashtësisë së rrënjës nga e cila kemi dalë!

Le ta shohim problemin më shkoqur. Është provuar tanimë katërcipërisht mbi baza shkencore se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve, të asaj popullsie të madhe të pjesës perëndimore të Ballkanit, që shtrihet nga gadishulli i Istries... etj., deri në gjirin e Ambrakisë (gjiri i Artës). Sipas Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, përmenden shumë emra fisesh, por emri i përbashkët ilirë, del vetëm në shekullim V para erës së re, i përmendur nga Herodoti, L.196.

Ta pranojmë se kultura ilire del në dritë aty nga epoka e bronzit të vonë (2100-1200) para erës së re; del pyetja që nga kjo epokë deri në shekullin V, kur lindi shteti ilir dhe formohen qytetet ilire, ç'ka ndodhur, me se është mbushur kjo hapësirë

kohore, me poçeri, me qeramikë, me farkëtim shpatash, heshtash, hanxharësh, me disa gloza të trashëguara si **sika** (thika), **pele** (pleq), **aspetos** (i shpejtë), apo me disa emra që shpjegohen me fjalët shqipe si **Dardania** (dardhe), **Dalmaci** (dele, delme), **Bardhyl** (bardhë)?

Për toponimin Ulqin jepet shpjegimi me fjalën **ujk** (Fjalori Enciklopedik Shqiptar) në fakt duhet **ulk** (thuhet në Gjirokastër), këndeje dhe **ulkonjë**. Por nuk duhet ndalur këtu. Në greqisht **lykos** (likos) është ujku, në serbokroatisht **vuk**, në rusisht **vollk**, bullgarisht **vëllk**. Kjo analogji gjuhësore është mbi bazën e origjinës indoevropiane. Por këtu është fjala për lidhjen me mitin pellazg. Sipas tij, Likaoni, ishte biri i Pellazgut dhe i pari që civilizoi Arkadinë, një nga banimet më të njohura të pellazgëve. Këtë kujtesë mitike e gjejmë sot në emrin e përveçëm njeriu, **Uk**, në veri të Shqipërisë, madje dhe te ilirët e sllavizuar në Mal të Zi, **Vuk**. Zeus **lykaeos** na vjen së lashti nga mitologjia pellazge. Te romakët kemi **Luperka**, emër i një hyjnie të lashtë, që, sipas legjendës, ushqeu Romulin dhe Remin (nga fjala latine **lupus**, ujk).

Duke vëzhguar qytetërimet e tejlashta parahistorike të popujve të ndryshëm që kanë pasë jetuar në Azinë Qendrore dhe, pas një shpërnguljeje të madhe kanë lëvizur në drejtime të ndryshme drejt Europës, Azisë së Afërme, Afrikës dhe më gjerë, të krijohet përshtypja se je përpara një pluhuri nebuloz kozmik, që duket si një re e stërmadhe me konture të papërcaktuara, pas së cilës fshihen yjet që lëshojnë veç një dritë agu të mugët, mezi të dallueshme. Turma njerëzish primitivë të paleolitikut e, madje dhe më herët, u ngjizën shkallë-shkallë në fise dhe popuj në amalgamë të një trangu të përbashkët, që me kohë lëshoi degëzime dhe një prej të cilëve duhet të jetë ajo popullsia e madhe që njihet me emrin pellazgë, në gjirin e së cilës gjalluan fise të ndryshme.

Ndarja e këtyre popujve në grupe të veçanta gjuhësore, sipas veçorive morfologjike e fonetike është një konvencion linguistik, por kjo nuk na pengon të dallojmë atë ç'kanë të përbashkët në mënyrën e përceptimit fantastik të botës, mitet, kultet, ritet, zakonet, bestytnitë etj., çka qenë kushtëzuar nga ngjashmëria në zhvillimin e tyre lëndor, shpirtëror e konceptual.

Studimi i gjuhës në zhvillimin historik të saj ka rëndësi të veçantë për të hedhur dritë mbi shumë çështje që kanë lidhje me etnologjinë, me stadet e zhvillimit të kulturës materiale e shpirtërore të një kombi, por kjo nuk duhet të pengojë për ta parë, ta zemë, një fjalë të caktuar, të analizuar në laboratorin linguistik, përtej ligjësive gjuhësore.

Le të marrim si shembull fjalën **dru**. Pellazgët kishin kult për r drurin, i cili, si i tillë, ka arritur deri në ditët tona. Sipas leksikologjisë, këtë fjalë, si indoeuropiane që është, e gjejmë në disa gjuhë: në rus, **djerevo**; në gr. e vjetër, *drys* (dushk, por dhe në përgjithësi dru, pemë); në serb.-kroat. **drvo** (lexo **dërvo**), në fiset kelte gjejmë **druidë**, priftërinj, që gjenin veti misterioze te disa lloje drurësh.

Druri, në mënyrë të veçantë lisi, është thjesht kult i pellazgëve, që ne, pasardhësit e tyre, e kemi trashëguar të gjallë deri në ditët tona. Legjenda tregon se hyjnesha Dija, që shkaktonte shiun dhe që mund të jetë dielli, e bashkuar me Apollonin, që të dy hyjni pellazge, lindën **Dryopin**. Alegoria, pra, është e qartë: shiu i bashkuar me diellin lindën drurët, bimësinë. Nga frika e t'et Dija e fshehu fëmijën në një lis të zgavruar. Dija lidhet me emrin e Iksionit, hero i kultit të lisit, pinjoj të të cilit mbaheshin Lapitët dhe Kentaurët. Këta kanë qenë fise primitive malore në veri të Greqisë. "Pasardhës të këtyre racave të lashta neolitike janë ruajtur në malet e Arkadisë dhe në Pind deri në periudhën klasike, kurse gjurmët e gjuhës së tyre parahelene i gjejmë në Shqipërinë e sotme".³ Për këtë argument, mund të shkruhen faqe të tjera, siç është bërë edhe në ndonjë shkrim më parë. Po shënojmë shkurt:

- Në tempullin e Dodonës pellazge ekzistonte kulti i lisit. - **Dryadat**, nymfat e pyjeve, **Qariatidat**, nymfat e arrës (nga fjala shqipe **qarr**).

Kulti i drurit ka qenë i përhapur te pellazgët dhe më gjerë. Në dramën "Vilhelm Teli" Shileri tregon se zviceranët besojnë se, po t'i presësh drutë me latë (sëpatë e vogël), u del gjak. Drurët kanë magji. "Kujtdo që atyre u bën dëm / Pas vdekjes i del dora jashtë varrit".

Autorë të ndryshëm kumtojnë se hyjnesha Artemidë i dha anijes Argo për direk një nga lisat fatthënës të Dodonës pellazge

në ekspeditën e argonauteve, të prirë nga Jasoni pellazg. Të gjitha këto dhe të tjera na shtyjnë të besojmë se kemi të bëjmë me një nënshtresë parahelene dhe parailire, pra pellazge, çka ka rrezatuar gjerë dhe është trashëguar e gjallë në shumë elemente të saj me prirje të dukshme për të vërtetuar prejardhjen e ilirëve dhe të shqiptarëve nga pellazgët hyjnorë, siç i ka quajtur Homeri.

“Për këtë substrat të tejlashtë, për këtë popullsi indoeuropiane të Ballkanit Perëndimor të epokës së eneolitit, a mund të përdoret një emër i përveçëm? Termi pellazg, që trashëgojmë nga burimet antike dhe që mendojmë se gjen mbështetjen pjesërisht nga të dhënat arkeologjike, mund të përdoret në kuptimin konvencional, me një përmbajtje e domethënie të caktuar. Kështu, bashkësia e gjerë kulturore e kultike dhe pjesërisht etno-gjuhësore, që u formua gjatë eneolitit në Ballkanin Perëndimor, mund të quhet pellazgjike.⁴

Ky vështrim i arkeologut M.Korkuti mendoj se është me mjaft interes, sepse lë shteg për ta kapërcyer atë hije skepticizmi që është dukur aty-këtu lidhur me problemin në fjalë, veçse duhet shtuar këtu se bashkësia kulturore e kultike që u formua gjatë eneolitit në Ballkanin Perëndimor, nuk është e njëkohshme për të gjithë popujt. Pellazgët në këtë mes kanë pjesën e tyre të veçantë, që shtyhet shumë më përpara eneolitit. Po hyjnitë, të cilët në epokën e thellë prehistorike nderoheshin në formën e tyre totemike theriomorfe (në pamjen e kafshëve të egra në përgjithësi) si gjarpri, ujku, dhia e egër, shqiponja etj., apo sendet, dukuritë natyrore, si deti, qielli, toka, etj., që u hyjnizuan dhe morën emra të përveçëm, apo druri, lisi, guri, uji etj, të cilët u shndërruan në kulte, për të ardhur më vonë te hyjnitë antropomorfe si Kroni, Urani, Zeusi, Hera, Atena, Dhemetra, Afrodita, Artemida, Apolloni e shumë të tjerë; tërë ky univers fantastik mos vallë u ngjiz në kohën e bronzit? Të gjitha këto zunë fill mijëra vite më parë se epoka e eneolitit, kur njeriu primitiv jetonte nëpër shpella. Shumëçka nga ky univers i stërlashtë: hyjni, kulte, rite, zakone i kemi ruajtur dhe i kemi mbajtur gjallë në rrjedhën e shekujve, deri në ditët tona, më shumë në viset malore, thuajse të pashkelura nga dyndje fisesh e popujsh.

Le të shohim një fakt, për të hedhur paksa dritë mbi hyjni dhe heronj të njohur të lashtësisë. Në Dodonën pellazge, Zeusi Dodonas (Homeri) me Eginën lindën Ajakun ose Eakun. Nga ky bashkim lindi Peleu, i cili me hyjneshën Tetis lindi Akilin; nga Telamoni lindi Aiaksi. Këndej zuri fill fisi i Pelidëve dhe i Aiakidëve, të cilët kishin të shenjtë kultin e lisit të Dodonës, i cili me fëshfërimën e gjetheve të tij jepte orakujt që interpretoheshin nga priftërinjtë të quajtur Selë. Në Dodonë heroin e luftës së Trojës, Akilin, e quajnë me gjuhën e vendit **aspetos**, siç e quan Homeri **këmbëshpejtë**.

Odisea, para se të kthehej në atdhe, në Itakë, pas rrënimit të Trojës, shkon në Dodonë të marrë vesh nga gjethet e lisit të Zeusit se ç'fat do të kishte gjatë udhëtimit të tij. Penelopa, gruaja e tij, i quan thesprotët dodonas "Miqtë tanë me besë".⁵

Një pikë referimi me rëndësi që konvergjon drejt ndriçimit të problemit në fjalë, është ishulli i madh Kreta, banuar që në periudhën e neolitit, aty nga mijëvjeçari IV dhe III. Në Kretë u dynd një popullsi e ardhur nga Lindja, e cila ndërtoi një qytet me mure qiklopikë, të njohur ndryshe dhe pallazgjikë, Gortynin, në këmbët e malit Ida. Vetë toponimi dhe mitet flasin për praninë e pellazgëve në Kretë, para shfaqjes së helenëve në jug të gadishullit ballkanik.

Këtu dhia Amaltea ushqeu Zeusin me qumështin e saj. **Amaltea:** nga shqipja **tamël**, qumësht. Tjetër element pellazg në Kretë është fakti se veshja e grave të Kretës së lashtë është një me atë të Malësisë së Shkodrës.⁶ Të gjitha këto, janë argumente me shumë rëndësi dhe elemente që dëshmojnë se Kreta u banua që nga epoka neolitike prej paraheleneve që ishin vetë pellazgët.

Prof. E. Çabej mendon se njësia ballkanike ekziston edhe në Lindjen e Afërme, në Siri dhe në Palestinë. Këto ndoshta mund të kenë lidhje shumë të vjetra.⁷

Kur vihesh të shkruash për pellazgët, të duket se po të sulmon një ortek marramendës, që, duke u përplasur nëpër shkëmbinjtë e kohëve, thërrmohet në mijëra grimca, pas të cilave fshihet "një mister" që xixëllon të rizbulohet për t'u salduar në një kohezion, tanimë të tronditur në rrymën e shekujve. Të vijnë në mendje një mori të dhënash, faktesh reale apo të

hamendësuar, që nuk është e lehtë t'ua gjesh fillin për një lidhje të brendshme ndërmjet tyre. Nocioni "pellazg" është një univers në një shtrirje të gjerë gjeografike e kohore, i rrëshqitshëm dhe hipotetik, gjithsesi real dhe bindës me aq shumë të dhëna të natyrave të ndryshme dhe me atë informacion që na vjen nga autorët antikë dhe nga studiuesit e kohëve moderne.

Janë me dhjetëra historianët e Greqisë së lashtë dhe të Romës që kumtojnë se pellazgët në trevat e Ballkanit kanë qenë para grekëve, madje duke i lokalizuar në vise të ndryshme të Greqisë dhe me gjerë në Ballkan, në Azi të Vogël, në Azinë Qendrore, në gadishullin Italik etj.

Mund të përmendim disa gjurmë të botës pellazge, që kanë lidhje me problemin e etnogjenezës së shqiptarëve. Dhe këto, jo vetëm në Ballkan, por më thellë në lindje të tij.

B. Terraçini në veprën e tij "Toponomastika sarde, f. 112, duke folur për shumësin e disa fjalëve që mbarojnë me -ar, sjell si shembull **clan**, shumësi **clenar**; shënon se një dukuri e tillë vërehet edhe në gjuhët kaukaziane.

Në një vrojtim që bën G. Dottin në veprën "Popujt e vjetër të Evropës, P. 1916" për fjalën **oior** (njeri) e cila në shumës bën **enarees** (njerëz) në gjuhën e skithëve, shohim një analogji të pastër me gjuhën shqipe. Por kjo dhe të tjera të natyrës gramatikore ndodhin ngaqë janë të rrënjës indoeuropiane. Ndryshe është kur takojmë toponime, etnonime, antroponime e të tjera, që na kujtojnë iliro-pellazgët.

Për përhapjen gjeografike të tyre, takojmë toponime si këto dhe shumë të tjera që flasin në gjuhën shqipe: Dacia maluensis-Dakia malore (Mark Aureli), Dacia ripensis-Dakia me male rrypa-rrypa, të thepisura (Diokleciani). Në Atikë njihej një komunë malore me emrin Skambonidhe-vis shkëmbor.⁸ Në kufirin midis Çekisë dhe Polonisë kemi vargmalet Karpate-shqip karpë, shkrep; malet Beskide-shqip bjeshke. Ka folur E. Çabej për këto të fundit.

Të ç'epoke janë këto emërtime? Problem i vështirë, por që ngacmon. Për këtë dhe të tjera duhet të merren ekipe studiuesish për t'i ardhur sa më pranë të vërtetës historike. Ngacmues janë etnonimet **pellazgë**, **albanë**, **ilirë**, që ndërthurren dhe shfaqen

ngatërrimisht në kohë. Krahas pellazgëve, vërejmë të flitet për **albanët** dhe **Albania**, në Azinë Qendrore, në Kaukaz e më gjerë, madje dhe për **hyllët**, për **bardejtë**.

Albania-n autorët romakë Plini (shek. I, era e re), Taciti (shek. II, era e re) e shënojnë si fis në brigjet e detit Kaspik: **albanët**. Si fis ilir, përmenden albanët (Albanoi) për të parën herë bashkë me qytetin e tyre **Albanopulos** nga gjeografi dhe *astronomi* Ptoleme (shek. I-II, era e re).

Këto dhe jo pak të tjera mbeten ende për t'u hulumtuar.

¹ Neritan Ceka, "Ilirët", Tiranë, 2000, fq. 33.

² G.Dottin. "Popuj të vjetër të Evropës". P.1916, fq. 129.

³ Robert Grevs në veprën "Mitet greke", 1972, v.I, fq. 364.

⁴ Muzafer Korkuti. Parailirët, Ilirët Arbërit. T.2003, fq. 23.

⁵ "Odisea", kënga VI, vargu 524.

⁶ "Encik.greke", volumi XV, f. 171, Athinë, 1931.

⁷ "Studime gjuhësore", vëll. V. fq. 209.

⁸ A. Bailly, "Fjalori Greqisht (e vjetër) – Frëngjisht", Paris, 1950.